

VENDIM
Nr. 147, datë 11.3.2022

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 935, DATË 25.11.2020, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT, PËR
FINANCIMIN E RIFORCIMIT TË NJËSIVE TË BANIMIT NË NDËRTESA
(PALLAT) DHE BANESAVE INDIVIDUALE, NË BASHKITË DURRËS DHE
LEZHË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 13, shkronja “b”, nënndarja “i”, dhe 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019; të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 115/2021, “Për buxhetin e vitit 2022”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 4, të vendimit nr. 935, datë 25.11.2020, të Këshillit të Ministrave, shtohet pika 4/1, me këtë përmbajtje:

“4/1 Përdorimi i fondit të rindërtimit, për vitin 2022, nga Bashkia Lezhë, për financimin e riforcimit të njësive të banimit në ndërtesa (pallat) dhe njësive individuale të banimit, të cilat janë klasifikuar si objekte me dëmtime të mëdha strukturore ose dëmtime shumë të rënda jostrukturore dhe që nuk duhen rindërtuar nga e para, është në masën 408 311 115 (katërqind e tetë milionë e treqind e njëmbëdhjetë mijë e njëqind e pesëmbëdhjetë) lekë, i cili përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2022 dhe i transferohet Bashkisë Lezhë në formën e transfertës së pakushtëzuar.”.

2. Ngarkohen Zëvendëskryeministri dhe ministri i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Lezhë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj